



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**KONTRATA**

**Numri i kontratës: 101-22-13278-2-3-5 /C101**

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë dhe

**RROTA, SHPK**, Prishtinë (Adresa: L. Arbëria 3, Rr. Ahmet Krasniqi: Tel.: +383 49 776 188; E-mail: pmo@rrota.com; NUI: 810490714) (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

**Mirëmbajtja, hostingu dhe web castingu i Web Faqes së Kuvendit të Kosovës**

me numër prokurimi: **101-22-13278-2-3-5 (KU101 22 044 235)**

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Mirëmbajtja, hostingu dhe web castingu i Web Faqes së Kuvendit të Kosovës**

1.2 Kontrata hyn në fuqi më: **05.12.2022** dhe përfundon më: **04.03.2023**

1.3 Afati i kryerjes së shërbimeve është **3 muaj** nga data hyrjes në fuqi të kontratës

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë **Kuvendi i Republikës së Kosovës**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP<sup>1</sup>** (Detyra e Dërguar e Paguar).

**Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **2,218.40 €** (Dymijë e dyqind e tetëmbëdhjetë euro e katërdhjetë centë)

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

---

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

#### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në euro.

**Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën për çdo muaj, pas pranimit të shërbimeve.**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

#### **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

#### **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

#### **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të furnizimeve.

#### **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i kryejë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## **Neni 11          Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## **Neni 12          Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## **Neni 13          Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatë (shih KVK) në pajtim me ligjin e Kosovës.

## **Neni 14          Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.




E hartuar në **gjuhën shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

## KUSHTET E VEÇANTA

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
<b>Ligji i zbatueshëm dhe gjuha</b>	2.1	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.</li> </ul>
	2.2	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.</li> </ul>
<b>Cilësia e shërbimeve</b>	6	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të gjitha shërbimet duhet të jenë në pajtim me kërkesat e specifikimit teknik në Dosje të Tenderit.</li> <li>Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas kryerjes së shërbimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se <b>shërbimet</b> janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë.</li> </ul>
<b>Dëmet e likuiduara</b>	8	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dëme të likuiduara: Autoriteti Kontraktues, për vonesë në kryerje të shërbimeve, operatorit ekonomik mund t'ia kalkulojë dëmet e likuiduara në shumën 0.25% në ditë deri në 10% të vlerës së kontratës.</li> </ul>
<b>Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes</b>	13.1	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese: 13.2</li> </ul>
<b>Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore</b>	13.2	<ul style="list-style-type: none"> <li>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.</li> </ul>

**Shënim:**

Kontratës i bashkëngjitet kopja e ofertës financiare e Operatorit Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues <b>KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b>		Për Operatorin Ekonomik <b>RROTA, SHPK</b>	
Emri dhe mbiemri	Xhemal Halili	Emri dhe mbiemri	Besa Gjonbalaj Gashi
Pozita:	Drejtor i Drejtorisë për Prokurim	Pozita:	Drejtoreshë Operacionale
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	05.12.2022	Data:	06.12.2022
Vula:		Vula:	



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupitina - Assembly


Titulli: Mirëmbajtja, hostingu dhe web castingu i Web Faqes së Kuvendit të Kosovës  
Nr. i Prokurimit: 101-22-13278-2-3-5 dhe Nr. i Drendshëm: KU101 22 044 235

**PËRSHKRIMI I ÇMIMIT**

Nr.	Emërtimi	Njësi matëse	Sasia	Çmimi me TVSH (€) për njësi	TOTALI me TVSH
1.	DOMAIN EMRAT: www.assembly-kosova.org www.kuvendikosoves.org www.skupitnakosova.org	3 muaj kohëzgjatje e kontratës komplet	1	59	59
2.	Hostingu	Muaj	3	330.4	991.2
3.	Mirëmbajtja	Muaj	3	212.4	637.2
4.	Web casting	Muaj	3	177	531

GJITHISEJ OFERTA ME TVSH	2,218.40
--------------------------	----------

**Shënim:**  
 Operatorë ekonomikë duhet t'i japin çmimet reale të tregut për shërbimet e ofruara.  
 Çmimet jo-normalisht të ulëta dhe çmimet më të larta se çmimet reale të tregut do të trajtohen në pajtim me Ujgjin e Prokurimit Publik.

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	Rrota sh.p.k
ADRESA E PLOTË	Rr: Bashkim Fehmiu, Hymja 5
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI	Besa Gjonbalaj Gashi
POZITA	Drejtoreshë Operacionale
NËNSHKRIMI	
DATA	25.11.2022
VULA	